

---


Me 29.05.2021  
Nr.01-21

Bazuar në Nenin 26 të Statutit të IRDK-së, Kryesia e IRDK-së, me qëllim të legjitimitimit  
e strukturave udhëheqëse të IRDK-së, merr

### V E N D I M

- I. Shpallen zgjedhjet e brendshme në IRDK.
- II. Zgjedhjet në nivel të degëve duhet të përfundojnë deri me 01.08.2021.
- III. Kuvendi i Përgjithshëm i IRDK-së duhet të mbahet gjatë muajit shtator 2021.
- IV. Miratohet udhëzuesi mbi procedurat e zgjedhjeve.
- V. Vendimi bëhet publik në ueb faqen zyrtare të IRDK-së.

Kryetar i IRDK-së  
**Elbert Krasniqi**



29.05.2021

## **Udhëzues për zgjedhjen e strukturave të IRDK-së bazuar në statutin e partisë**

### ***Zgjedhjet në Nëndegë***

#### **Kuvendi i Nëndegës**

- Kuvendin e Nëndegës e përbejnë të gjithë anëtarët e IRDK-së nga territori i nëndegës.
- Minimumi i numrit të delegatëve të nevojshëm për Kuvendin e nëndegës është më shumë se gjysma e anëtarëve të IRDK-së nga territori i nëndegës.
- Kuvendi i Nëndegës zgjedh:
  - o Kryetarin e nëndegës me shumicë të votave përmes votimit të fshehtë nëse paraqiten më shumë se një kandidat ose me votim të hapur nëse paraqitet vetëm një kandidat.
  - o Kryesinë e nëndegës prej 5 – 9 anëtarë prej të cilëve një nënkryetar, një sekretar dhe 3 – 7 anëtarë të Kryesisë. Votimi i Kryesisë bëhet në pako duke i poentuar secilin me pikë prej 1 – 5. Ai/Ajo që ka marrë më së shumti vota zgjidhet nënkryetar dhe më i votuari i radhës zgjidhet Sekretar.
  - o Delegatët e Kuvendit të degës. Numri i delegatëve përcaktohet përmes Tab.2

### ***Zgjedhjet në Degë***

#### **Kuvendi i Degës**

- Kuvendi i Degës përbëhet prej delegatëve të zgjedhur nga Kuvendi i Nëndegës. Numri i delegatëve për secilën degë është përcaktuar në Tab.2.
- Kuvendi i degës zgjedh:
  - o Kryetarin e degës me shumicë të votave përmes votimit të fshehtë nëse paraqiten më shumë se një kandidat ose me votim të hapur nëse paraqitet vetëm një kandidat.
  - o Kryesinë e degës prej 9 - 15 anëtarëve prej të cilëve: dy (2) nënkryetar, sekretarin organizativ dhe 6 – 12 anëtarë të Kryesisë.
  - o Delegatët e Kuvendit të Përgjithshëm. Numri i delegatëve përcaktohet përmes Tab.1

## ***Zgjedhjet qendrore***

### **Kuvendi i Përgjithshëm**

- Kuvendi i Përgjithshëm përbëhet prej delegatëve të zgjedhur nga Kuvendi i degëve. Përfaqësimi i delegatëve nga secila degë është përcaktuar në Tab1. Numri i delegatëve të Kuvendit të Përgjithshëm është 81.
- Kuvendi i Përgjithshëm zgjedh:
  - o Kryetarin e IRDK-së me shumicë të votave përmes votimit të fshehtë nëse paraqiten më shumë se një kandidat ose me votim të hapur nëse paraqitet vetëm një kandidat.
  - o Këshillin Drejtues të IRDK-së prej 35 anëtarëve.

### **Këshilli Drejtues**

- Këshilli Drejtues i IRDK-së përbëhet prej 35 anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi i Përgjithshëm
- Këshilli Drejtues zgjedh:
  - o Kryesuesin e Këshillit Drejtues
  - o Kryesinë e IRDK-së prej 15 anëtarëve: 3 Nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, Kryetarët e degëve, Kryetari/ja i/e Forumit Rinor të IRDK-së nëse funksionon, Kryetarja e Forumit të Gruas nëse funksionon dhe anëtarët tjerë numri i të cilëve ndryshon në varësi të numrit të degëve.

